



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 644-42688 /2024

Klinë, datë 19 /12/2024

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare me 04.06.2008, nr.28/2010, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh propozimin e Drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit, kryetari i Komunës së Klinës, merr këtë:

V E N D I M

Për

Ndalimin e përdorimit dhe shitjes se paautorizuar të mjeteve piroteknike

1. **NDALOHET**, ndezja dhe përdorimi i fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike në hapësirat publike, përkatësisht tregje, rruge, shkolla, sheshe dhe zona të banuara, si dhe shitja e tyre nga persona dhe vende të paautorizuara.
2. Përjashtim nga ndalesa e ndezjes, behet më datën 24.12.2024 nga ora 18:00 deri në orën 01:00 të datës 25.12.2024, si dhe datën 31.12.2024 nga ora 18:00 deri 01:00 të datës 01.01.2025, por përdorimi i tyre duhet të behet në mënyrë të organizuar dhe kontrolluar.
3. Ndaj personave të cilët veprojnë në kundërshtim më këtë ndalese, do të ndërmerren masat sanksionuese në përputhje më dispozitat e Ligjit për Përdorim Civil të Eksploziveve, nr.04/L-022, Ligjit për Kundërvajtjet, nr.05/L-087, si dhe aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
4. **OBLIGOHET**, Drejtoria e Inspektoratit, qe në bashkëpunim më Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Klinë, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme ndaj shkelësve eventual të kësaj ndalese.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi më rastin e nënshkrimit të tij nga kryetari i komunës.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Inspektoratit;
- Stacioni Policor në Klinë;
- 1 kopje në tabelën e shpalljeve
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

